



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 26.02.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim të datës 21.02.2016 dhe plotesimit të kërkesës të datës 23.02.2018** të parashtruar nga Operatori Ekonomik "DWH-KOSOVA SHPK", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi me instrumente gjeodezike për monitorimin dhe kontrollimin e objekteve ndertimore"**, me Nr. të Prok: **616 -18-106-121** nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "DWH-KOSOVA SHPK" e datës 21 dhe 23.02.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi me instrumente gjeodezike për monitorimin dhe kontrollimin e objekteve ndertimore"**, me Nr. të Prok: **616 -18-106-121**, Nr. Brendshëm \_616 18 002 121 kundër *[Njoftimit për Kontratë të AK –së, të datës të publikuar në web-faqe të KRPP-së.*
2. **Vërtetohet** Njoftimi i AK për *kontratë*, i publikuar me datë: .02.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "DWH-KOSOVA SHPK" me datë 21.02.2018 ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi me instrumente gjeodezike për monitorimin dhe kontrollimin e objekteve ndertimore"**, me Nr. të Prok: **616 -18-106-121**; me Nr. të brendshëm të prokurimit: 616 18 002 121 Autoriteti Kontraktues, me datë 26.02.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- 1.Pretendimi i pare lidhur me numrin minimal te kanaleve eshte i pabazuar,pasiqe: Kërkesa jonë minimum për 400 kanale është shumë e pastër dhe aspak diskriminuese. Pra mund të ofrohet nga 400 e më shumë, po i'u rikujtojë se produktet e juaja ofrojnë GPS Rover mbi 550 kanale. Shiko dosjen e tenderit në specifikimet teknike të detyrueshme "Numrin e kanaleve të ketë jo më pak se 400 kanale" çdo numër kanali më me shumë është i mirë së ardhur. Lidhur me faktin se ka ndonjë Vendim te OSHP-se lidhur me kete,per ne nuk eshte i njohur.
- 2.Lidhur me pretendimin se specifikimet jane paushalle Vazhdojmë t'iu ripërgjigjemi se specifikat janë marrë nga websajti <http://www.geo-matching.com/> aty mund ti gjeni gjitha datasheetet nga janë përcaktuar specifikat;
- 3.Lidhur me pretendimin per matjet me Titl Sensor ju sqarojme prap se GPS duhet të ofroj till sensorin (matje pa vertikalitet steke) kjo është SHUMË E RËNDËSISHME PËR NE, sigurisht që do të jenë mirëpritur versionet më të thjeshta për të futur në punë GPS-in. Po ju rikujtojmë rishitas (megjithëse i'u kemi sqaruar edhe në shkresat paraprake) "Korigjimet e shmangies së gabimeve të qendërsimit të ketë jo më pakës se 10 (dhjetë shkallë)" është njëra nga specifikat që neve na shërben jashtë zakonisht shumë në natyrën e punëve për nevojat e institucionit. Po i'u rikujtoj se këtë specifik e ofron edhe produkti i juaj.
- 4.Lidhur me pretendimin per stacionin total poashtu referojuni sqarimeve nga pika 2;
- 5.Pretendimi per kërkesa diskriminuese ne pikat 8.1 dhe 8.2 eshte plotësisht i pabazuar per faktin se kërkesat janë mjaft te qarta dhe ne harmoni te plote me dispozitat ligjore dhe eshte ne shërbim te rritjes se konkurrencës,ndërsa pretendimi juaj per kriteret tjera do te ishte pikërisht diskriminues;
- 6.E njëjta vlen edhe per piken 9.1 dhe 9.2 te kriteret teknike dhe profesionale te cilat janë ne harmoni me dispozitat ligjore dhe rritjen e konkurrencës qe eshte nje nga qëllimet e prokurimit;
- 7.Pretendimi lidhur me demonstrimin e produkteve nga fituesi poashtu eshte i paqëndrueshëm,pasiqe prezentimin do ta bej kandidati i propozuar per dhënje te kontratës para publikimit te njoftimit per dhenje dhe nëse ai dështon vazhdohet me tenderuesin vijues qe d.t.th.se eliminohen vetëm tenderuesit e pa përgjegjshëm e jo ata qe plotësojnë kërkesat e FDT-se;
- 8.Pretendimi lidhur me afatin e trajnimeve poashtu eshte i pa bazuar per faktin se eshte e drejt e Autoritetit Kontraktues qe te përcaktoj kërkesat e veta ne harmoni me nevojat dhe qëllimin e projektit dhe i njëjti e ka parapa si te arsyeshëm dhe te nevojshëm afatin e trajnimit prej shtate ditëve;
- 9.Lidhur me pretendimet per afatet e garancisë ju sqarojmë se eshte poashtu e drejte e jona te kërkojmë afat garantues per produktet e reja dhe te përcaktojmë edhe kohëzgjatjen e afatit dhe ketu nuk ka asnjë humbje e "peshores"siqe pretendoni ju pasiqe kërkesa eshte e njejte per te gjithë tenderuesit dhe se çdo garancion përjashton dëmtimet e qëllimshme ne te cilat aludoni ju;
- 10.Poashtu eshte i pa bazuar edhe pretendimi lidhur me mirëmbajtjen,servisimin dhe kallupimin,pasiqe per produktin e ri me faktin se kërkohet garancioni duhet te parashihet edhe mirëmbajtja,servisimi dhe kallupimi.Pretendimi juaj se këto shërbime nuk mund t'i kryej nje kompani qe ka qarkullim vjetor prej 35,000.00 eurove poashtu eshte i pabazuar dhe tendencioz,pasiqe kjo varet ne radhe te pare nga përgatitja profesionale e stafit te kompanisë dhe qarkullimi nuk eshte indikator i rëndësishëm ne kete aspekt;dhe



-Poashtu ju sqarojmë se specifikimet teknike janë zgjedhur thjesht që të kemi pajisjet e gjeodezike në mesin e më të mirëve të mundshëm, për nevojat e institucionit tonë, për sfidat e punës profesionale që na presin neve si staf, sepse ne jemi ata që përballemi me terrenin dhe kjo është e drejta jonë për të kërkuar specifika teknike më të larte.

-Edhe pretendimet tuaja lidhur me afatet për pergjegjet dhe sqarimet tona nuk janë të bazuara, pasi që ne rastin kur janë vonuar sqarimet apo nuk ka pas mundësi të kthehen brenda afatit ne kemi bere vazhdim të afatit për dorëzime të tendereve, ndërsa lidhur me kërkesën për rishqyrtim poashtu sot është afati ligjor për pergjegje e jo siq pretendoni ju.,

-Për fund ju sqarojmë se në dosjen se tenderit nuk ka asnjë kerkese që është në kundërshtim me dispozitat ligjore, përkundrazi kërkesat ne te cilat ju aludoni do te ishin diskriminuese dhe te pa ligjshme. Për te dëshmuar kete lexoni Interpretimin e KRPP-se lidhur me kriteret për procedurat për furnizimet e ofruara kur ofertuesi nuk është prodhues i tyre:

57. Duke marrë për bazë kërkesat e shumta të Autoriteteve Kontraktuese, Operatorëve Ekonomik si dhe palëve tjera, për interpretim dhe sqarim, të nenit 68 dhe 69 të LPP-se lidhur me "Gjendjen Ekonomike dhe Financiare" dhe "aftësitë teknike dhe/ose profesionale" përkatësisht në lidhje me dëshmitë e kërkuara nga AK, për te dëshmuar përmbushjen e këtyre kërkesave, KRPP sqaron si në vijim:

Në pajtim me nenin 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 ofron interpretimin ligjor si në vijim::

Në përputhje me nenet 68 dhe 69 të këtij ligji, Autoritetet Kontraktuese gjatë vendosjes së kërkesave lidhur me Gjendjen ekonomike dhe financiare dhe aftësinë teknike dhe/ose profesionale MUND të kërkojë nga OE-të që të sigurojnë nëse është relevante dhe e nevojshme njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuar në paragrafin 1 të nenit 68 dhe në paragrafët 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 të këtij ligji.

Në të gjitha rastet e përfshira në paragrafin 1 të nenit 68, paragrafëve 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 përmendet shprehja si në vijim citojmë: ".....të realizuara në tri vitet e shkuara "ose "...në periudhën e shkuar trevjeçare..."). Në kuptimin e Ligjit shprehja "tri vitet e shkuara" nënkupton: "Periudhën kohore të përcaktuar në këto nene e cila ndërlidhet me periudhën që paraprinë datën e publikimit të njoftimit për kontrate ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim. Në kuptim të nenit 69 paragrafi 2.1, 4.2 dhe 6.2 shprehja ".....të realizuara në tre vitet e shkuara" nënkupton Kontratat për furnizime, shërbime dhe/ose pune të realizuara (përfunduar) në periudhën e shkuar tre vjeçare (periudha e sqaruar si më lart).

Sqarimi:

Në rast se Autoriteti Kontraktues inicion një aktivitet prokurimit që ka për qëllim furnizimin me mallra, shërbime dhe/ose kryerjen e punëve ndërtimore dhe VENDOS te kërkojë përmbushjen e kërkesave nga neni 68 dhe/ose 69 lidhur me Gjendjen ekonomike dhe financiare dhe aftësinë teknike dhe/ose profesionale, duke kërkuar nga OE për te ofruar dëshmi përkatëse të lidhura me "periudhën e shkuar tre vjeçare", Autoritetet kontraktuese DUHET të specifikojnë qarte në Njoftimin për Kontrate dhe Dosjen e tenderit (Fleta e të dhënave për Ofertën), periudhën për të cilën janë kërkuar dëshmitë.

Në çdo mënyrë periudha (tre vjeçare) duhet të përfshijë edhe vitin vijues në të cilin është iniciuar aktiviteti. Në këto situata rekomandohet që data nga e cila fillon të kalkulohet periudha e shkuar tre vjeçare të vendoset Data e publikimit të Njoftimit për kontrate, përkatësisht e dërgimit të ftesës për

pjesëmarrje.


Në të njëjtën kohë, KRPP, sqaron se kërkesat e vendosura sipas neneve 68 dhe 69 mund të përmbushen në cilën do pjesë të kësaj periudhe (p.sh brenda njërit vit të periudhës) apo në tere periudhën e caktuar nga vete autoriteti kontraktuese. Po ashtu, duke pas parasysh qëllimin për të cilin kërkohet përmbushja e kërkesave nga neni 68 dhe/ose 69, KRPP, këshillon Autoritetet Kontraktuese që të vlerësojnë nëse aplikimi i kërkesave për të dëshmuar gjendjen ekonomike dhe financiare apo aftësitë teknike dhe profesionale është e nevojshme.

KRPP ka vërejtur se shume AK i aplikojnë ato (kërkesat e nenit 68 dhe/ose 69 të LPP-se) edhe për rastet kur nuk kanë ndonjë rëndësi apo nevojë për tu dëshmuar. (P.sh, për aktivitetet të cilat kanë për qëllim furnizimin me mallra e të cilat nuk prodhohen nga ofruesi i tyre). Në këto aktivitete aplikimi i kriterëve nga neni 68 dhe/ose 69 nuk është i arsyeshëm përkundrazi është jo profesional dhe mund të shkaktoj probleme të panevojshme.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në sqarimet e dhëna më lartë ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit